

Syllabus për lëndën VLERËSIMI FINANCIAR I BIZNESEVE

TË DHËNA BAZIKE TË LËNDËS	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik – Universiteti i Prishtinës
Titulli i lëndës:	Vlerësimi Financiar i Bizneseve
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Semestri III (viti II-të)
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	4 ECTS
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Sead Ujkani
Detajet kontaktuese:	sead.ujkani@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Vlerësimi i biznesit është i përhapur, kompleks dhe kritik për vendimmarrjen. Përmes lëndës ofrohen njohuritë për qasjet dhe metodat themelore për vlerësimin e biznesit. Studentët do të aftësohen të aplikojnë metodologjinë adekuate në përcaktimin e vlerës së biznesit. Lënda prezanton një gamë të gjerë çështjesh të vlerësimit të biznesit dhe ndikimin e tyre për një sërë palësh të interesuara. Ndërsa, ka koncepte të reja të prezantuara në këtë lëndë, theksi vihet në zbatimin praktik të koncepteve të financës dhe kontabilitetit për vlerësimin e biznesit
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi kryesor i lëndës është të mundësojë një kuptim të plotë të vlerësimit të bizneseve dhe të zhvillojë aftësitë për të aplikuar konceptet dhe teknikat e vlerësimit të biznesit në praktikë.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të jenë në gjendje të: (a) kuptojnë dhe shpjegojnë procesin e vlerësimit të bizneseve; (b) aplikojnë metodat e vlerësimit të biznesit, metodën e fluksit të skontuar të parasë; (c) të kuptojnë standardet, parimet dhe teknikat për vlerësimin e biznesit; (d) të njohin dhe analizojnë raportet financiare për vlerësimin e biznesit dhe vlerësimin bazuar në fluksin e lirë të parasë; (e) përgatisin raportin e vlerësimit; (f) zbatojnë teoritë dhe metodat e mësuara në aplikimet financiare në botën reale.

Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Ushtrime praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin / konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	1	4	4
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	4	4
Totali			100 orë
Metodologjia e mësimdhënies:	Sipas orarit të përcaktuar të ligjëratis, mësimdhënia do të zhvillohet përmes shpjegimit teorik të materialit mësimor, detyrave praktike, analizës dhe diskutimeve të rasteve studimore, si dhe punimeve individuale apo edhe grupe për vlerësimin e një biznesi. Detyrat praktike, analiza dhe diskutimi i rasteve studimore, si dhe përgatitja e punimeve, u mundësojnë studentëve të zhvillojnë kompetencën e tyre për vlerësimin e biznesit, si dhe duke zhvilluar më tej aftësitë e tyre të komunikimit dhe të menduarit kritik. Njëkohësisht, studentët duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë aftësitë e tyre, që realizohet duke përfunduar me sukses detyrat e caktuara, punimin, aktivitetin gjatë orës mësimore, vlerësimet periodike, si dhe përmes provimit. Çdo student duhet të lexojë materialin përpara ligjëratis, të kryejë detyrat e caktuara pas ligjëratis dhe të jetë i përgatitur për t'i diskutuar ato në ligjëratis vijuese. Pra, studentët duhet të jenë të përgatitur për të marrë pjesë në diskutimet gjatë ligjëratis, për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe për të zgjidhur detyrat e caktuara. Ligjëratat teorike, detyrat praktike dhe materialet tjera mësimore do të ofrohen përmes shfrytëzimit të platformave të teknologjisë informative, si dhe do të publikohen në SEMS apo edhe në klasën virtuale të krijuar në platformën Google Classroom.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi bazohet në pikët kumulative të fituara gjatë semestrit. Pikët fitohen nga testet periodike, detyrat, punimi dhe pjesëmarrja në diskutime gjatë ligjëratis. Vlerësimi i studentëve konsiston në: - Testi i parë 35 pikë - Testi i dytë 35 pikë - Pjesëmarrja & Angazhimi në orën mësimore 10 pikë - Detyrat, punimi 20 pikë Gjithsej: 100 pikë		

LITERATURA	
Literatura bazë:	- Valuation: the art and science of corporate investment decisions/Sheridan Titman, John D. Martin.—[Third edition], ISBN 978-0-13-347952-2, 2016. - Business Analysis & Valuation: Using Financial Statements, 5th edition Krishna G. Palepu and Paul M. Healy, 2013. - Materialet e përgatitura, ligjëratat, rastet e studimit dhe detyrat praktike.
Literatura shtesë:	- Damodaran on Valuation (Linku: https://pages.stern.nyu.edu/~adamodar/New_Home_Page/dam2ed.htm) - Valuation: Measuring & Managing the Value of Companies, Professor David Wessels, the Wharton School of the University of Pennsylvania, Lecture Notes and Readings (Linku: https://finance.wharton.upenn.edu/~wessels/valuation5e/powerpoint/lecture_notes.htm)
PLANI I DIZEJNUAR I MËSIMIT:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Prezantimi i lëndës dhe hyrje në vlerësimin e bizneseve
<i>Java e dytë:</i>	Standardet e vlerësimit të bizneseve
<i>Java e tretë:</i>	Teoritë dhe praktikatat e vlerësimit të bizneseve
<i>Java e katërt:</i>	Qasjet për vlerësimin e biznesit
<i>Java e pestë:</i>	Parimet dhe teknikat për vlerësimin e biznesit
<i>Java e gjashtë:</i>	Korniza për analizën dhe vlerësimin e biznesit përmes pasqyrave financiare
<i>Java e shtatë:</i>	Raportet financiare për vlerësimin e biznesit
<i>Java e tetë:</i>	Vlerësimi bazuar në fluksin e lirë të parasë
<i>Java e nëntë:</i>	Testi 1
<i>Java e dhjetë:</i>	Vlera e shtuar e tregut dhe vlera ekonomike e shtuar
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Vlerësimi i biznesit - Raste studimore, detyra praktike, analizë dhe diskutim
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Parashikimi dhe vlerësimi i flukseve të parasë, Metoda e fluksit të skontuar të parasë
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Analiza e ndjeshmërisë dhe analiza e skenarit
<i>Java e katërmbëdhjetë:</i>	Modelimi financiar për vlerësimin e biznesit
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Testi 2

POLITIKAT AKADEMIKE DHE RREGULLAT E MIRËSJELLJES:
Pjesëmarrja në ligjëratat dhe ushtrime është e detyrueshme Studentët duhet të tregojnë standarde të larta të sjelljes. Studentëve u kërkohet të angazhohen në sjellje të respektueshme, të përgjegjshme dhe të përshtatshme. Gjuha ose sjellja e papërshtatshme ose joprofesionale nuk do të tolerohet. Studentët pritet të respektojnë orarin, të ruajnë disiplinën në klasë dhe të respektojnë kodin e nderit në ligjëratat, ushtrime dhe teste.

